

Njësia akademike:	Orientalistikë
Titulli i lëndës:	Autorët shqiptarë në gjuhët orientale
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	IV
Numri i orëve në javë:	2+0
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	Fakulteti i Filologjisë/ UP Prishtinë
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. dr. Abdullah hamiti
Detajet kontaktuese:	abdullahamiti@yahoo.com
Përshkrimi i lëndës	Lënda <i>Autorët shqiptarë në gjuhët orientale</i> u ofron studentëve njohuri për rrjedhat e zhvillimin e jetës kulturore-shkencore e arsimore në Perandorinë osmane, për pjesëmarrjen e shqiptarëve dhe kontributin e tyre në jetën kulturore, arsimore e shkencore në gjuhët orientale (arabisht, persisht e turqisht). Në ligjerata do të theksohen karakteristikat themelore të krijimtarisë në prozë e poezi të shqiptarëve në gjuhët orientale, format dhe përmbajtjet e asaj krijimtarië (të fushës shkencore, të disiplinës fetare dhe të letërsisë së bukur) si dhe vendi i kësaj krijimtarië brenda qytetërimit osman dhe oriental-islam në përgjithësi. Më pastaj do të prezentohen personalitetet më eminent shqiptarë që kanë shkruar në gjuhët orientale (në aspektin biobibliografik) dhe veprat më të rëndësishme, duke i vlerësuar edhe në kuadër të traditës islame edhe në kuadër të historisë kulturore të shqiptarëve.
Qëllimet e lëndës:	<ul style="list-style-type: none"> - t'i njoftojë studentët e Orientalistikës për pjesëmarrjen e shqiptarëve në jetën kulturore-shkencore e arsimore në Perandorinë Osmane; - t'i njoftojë studentët me krijimtarinë e shqiptarëve në gjuhët orientale (arabisht, persisht, turqisht) e cila është krijuar nga fillimi i shekullit 16 e deri në fillim të shekullit 20; - të ngriten debate dhe diskutime që do të nxisnin mendimin kritik të studentët për vlerat e kësaj krijimtarië; - t'i kuptojnë shkaqet dhe impaktet e krijimtarisë së shqiptarëve në gjuhët orientale në kulturën osmane në përgjithësi.
Rezultatet e pritura të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> - t'i përshkruaj karakteristikat prozaike dhe poetike të krijimtarisë së shqiptarëve në gjuhët orientale; - të diskutojë për disiplinat në të cilat kanë shkruar

	shqiptarë në gjuhët orientale; - t'i identifikojë autorët më të dalluar dhe të diskutojë për vlerat e tyre kulturore e historike;		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxëniet të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike			
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren			
Kollokfiime, seminare			
Detyra të shtëpisë	2	15	30
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgaditja përfundimtare për provim	2	15	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	1	2
Projektet, prezentimet ,etj	2	1	2
Totali			124
Metodologjia e mësimdhënies:	Mësimi është mësim i rregullt me formën e ligjeratave 2 orë në javë. Do të diskutohet pjesëmarrja e shqiptarëve në kulturën orientale-islame në gjuhët orientale (arabisht, persisht, turqisht) duke lexuar tekste që do të zgjedhen nga autorët e ndryshëm.		
Metodat e vlerësimit:	Do të zbatohen këto metoda të vlerësimit: Vlerësimi i parë: 15% Vlerësimi i dytë: 15% Angazhimet e tjera 15% Vijimi i rregullt 5% Provimi final: 50% Totali 100%		
Literatura			
Literatura bazë:	Bursali Mehmed Tahir, <i>Osmanlı Müellifleri, I, II, III</i> , İstanbul, 1915. Dr. Necla Pekolay, <i>İslamî Türk Edebiyatı</i> , 3 kitap, İslam Medeniyeti Yayınları, İstanbul, 1968. Hasan Kaleshi, <i>Autorët e Kosovës në gjuhët orientale</i> , Kosova dikur dhe sot, Beograd, 1973.		
Literatura shtesë:	Hasan kaleshi, <i>Roli i shqiptarëve në letërsinë</i>		

	<i>orientale</i> , Seminari i kulturës shqiptare për të huaj, 2/1976, Prishtinë, f. 151-217 (Fakulteti Filozofik). Gazmend Shpuza, <i>Jeta letrare në gjuhët orientale në Shqipëri</i> , në PERLA, 2001/1-4, Tiranë, f. 3-23.) Mehmed Mujezinoviç, <i>Natpisi na nadgrobnim spomenicima Suzi Çelebija i Neharija u Prizrenu</i> , në POF XII-XIII/1962-63.
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Rrrethanat politike dhe kulturore që ndikuan që të rinjtë shqiptar që nga shek. XV të fillojnë të krijojnë në gjuhët orientale.
Java e dytë:	Inkuadrimi i shqiptarëve në jetë politike- administrative osmane dhe roli i tyre për përhapjen e shkollimit në trojet shqiptare.
Java e tretë:	Klasifikimi i disiplinave në të cilat kanë krijuar autorët shqiptarë në gjuhët orientale: letërsi, historiografi, gjuhësi, islamistikë, mjeksi etj.
Java e katërt:	Format letrare – poetike në të cilat krijuan autorët shqiptarë në gjuhët orientale: Mesnevia, Kasidja, Gazelia, Ilahia... dhe tematika që trajtuan autorët shqiptarë në gjuhët orientale.
Java e pestë:	Përfaqësuesit më eminent shqiptar në gjuhët orientale nga shek. XV dhe XVI: e deri tek ai XIX e XX, siç janë: Jahja bej Dukagjini, Prishtineli Mesih, Ahmet Bej Dukagjini, Suzi Prizrenasi, Azmi Zade, Nehari Prizrenasi, Prizrenasi Sa'ji, Shem'i, Behari, Axhize Baba e deri te Sami Frashëri e Mehmet Akifi.
Java e gjashtë:	Klasiku i madh turk Jahja bej Dukagjini – përshkrim i Divanit dhe pesë Mesnevive të tij.
Java e shtatë:	Vlerësimi i parë intermediar.
Java e tetë:	Historiografia osmane dhe kontributi i shqiptarëve në fushën e historiografisë.
Java e nëntë:	Mbi jetën dhe veprat e historiografëve më eminent osman-turq me prejardhje shqiptare, si: Lutfi Pasha, Koçi Beu, Mustafa Safi, Hajredin Leskoviku, Muhid Libohova e shumë të tjerë për të cilët do të jepet një pasqyrë më e gjerë.
Java e dhjetë:	Kontributi i shqiptarëve në disiplinat e ndryshme shkencore në gjuhët orientale. Dihet se në disiplinat e ndryshme shkencore, si islamistikë, gjuhësi-leksikografi, medicinë, filozofi-misticizëm, etikë, pedagogji, psikologji etj. janë dalluar shumë shkenctarë me prejardhje shqiptare për disa nga të cilët dihet më shumë edhe shumë të tjerë për të cilët dijmë pak.
Java e njëmbëdhjetë:	Dijetarë e njohur Sami Frashëri, Ibrahim Temo e Hoxha Tahsini dhe kontributi i tyre në shkencën turke të shek. XIX.

Java e dymbëdhjetë:	Autoët tjerë më pak të njohur për ne si Osman Efendi Dukagjini, Esat Janinasi, Abidin Pasha Dino, Besim Omer pasha (Akalin), Ibrahim Lutfi pasha, Abdulhaqim Hiqmet, Dervish Hima etj.
Java e trembëdhjetë:	Autorët shqiptarë që kanë shkruar edhe shqip edhe turqisht: Nezim Frakulla, Ethem Bej Tirana, Tahir Boshnjaku etj.
Java e katërbëdhjetë:	Sa u trajtuan deri tash dhe si duhet trajtuar nga shoqëria shqiptare këta autorë shqiptarë që shkruajtën në gjuhët orientale
Java e pesëmbëdhjetë:	Testi provues përfundimtarë
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
<p>Cakto politikat e mirësjelljes konfor statusit të UP-së. Vijimi në ligjërata duhet të jetë i rregullt, gjatë mbajtjes së mësimit duhet të mbretërojë qetësia, të shkyçen telefonat celular si dhe hyrja në sallë duhet të jetë me kohë. Plagjiarizmi dhe kopjimi në provime janë të dënueshme; studenti merr note negative.</p>	